

Prof. dr. Tomor Osmani

HAFIZ ALI ULQINAKU, JETA DHE VEPRA

Kultura, arsimi dhe historiografia shqiptare kanë nevojë gjithnjë e më shumë për të botuar trashëgiminë e së kaluarës qoftë edhe nga veprimtaria e klerikëve, veprat e të cilëve i shërbyen edhe çështjes sonë kombëtare.

Kohë më parë, studiuesit e mirënjohur, i ndjeri Faik Luli dhe Islam Dizdari, bënë një botim dinjitoz për jetën dhe veprën e Hafiz Ali Ulqinakut. Ky klerik patriot, në vitin 1978 u dekorua me medaljen *“Për veprimtari patriotike dhe si aktivist i dalluar dhe luftëtar i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit”*, ndërsa në vitin 1994 iu dha titulli *“Mësues i Popullit”*. Gjithë veprimtarinë e H. Ali Ulqinakut e përmbledh motivacioni i këtij titulli *“Klerik dhe intelektual i shquar, studiues i apasionuar, mësues dhe edukator i nderuar i rinisë dhe i masave popullore, hartues dhe përkthyes i veprave fetare-shkencore”*. Për këtë figurë është shkruar edhe më parë, por deri tani nuk është botuar një vepër e tillë, e plotë dhe e saktë për Hafiz Ali Ulqinakun. Dy autorët, bashkëpunëtorë të ngushtë, F. Luli dhe I. Dizdari, edhe më parë na kanë dhënë vepra me vlerë dhe të shkruara me kompetencë profesionale. Kujtojmë botimin me shumë interes *“Mevludet në gjuhën shqipe”*, që qarkulloi në vitin 2002.

Monografia që po recensojmë, është rrjedhojë e një pune shumëvjeçare të autorëve, të cilët kanë hulumtuar në biblioteka dhe arkiva për të dhënë një vepër të pasuruar me elemente dhe interpretime të reja. Qëllimi i tyre është i qartë: Kjo figurë shumëplanëshe, kontributi i së cilës vihet re në disa fusha dijeje, por dallohet si leksikograf, hartues abetareje, poet, përkthyes, pa lënë mënjanë detyrën e tij kryesore si klerik. Vlera e tij do të ishte e njëanshme, nëse nuk do të shquhej edhe si patriot dhe njëkohësisht edhe përdorues dhe përhapës i gjuhës shqipe në

veprat fetare. Një objektiv të tillë e kanë pasur parasysh hartuesit e monografisë, të cilët, që në parathënie, qartësojnë pikësynimet e tyre, kur shkruajnë: *“Në këtë veprë ne u tregojmë shqiptarëve se dijetarët tanë islamë, hoxhallarët tanë, kanë qenë gjithnjë krahas popullit, pranë tij e në shërbim të tij, jo vetëm në fushën e besimit, të edukimit, jo vetëm për shqetësimet e problemet e përditshme të jetës, jo vetëm në ballë të tij me pushkë në dorë për mbrojtjen e atdheut dhe të interesave kombëtare, por edhe në ballë të punës për mësimin dhe arsimimin e popullit në gjuhën shqipe”*. Njëri prej tyre ishte edhe Hafiz Ali Ulqinaku.

Autorët e veprës, F. Luli dhe I. Dizdari, e kanë konceptuar monografinë për ta paraqitur gjithë veprimtarinë e H. Ali Ulqinakut në gjuhën shqipe, ndonëse është shkruar me alfabetin arabo-turk, por e inkuadruar në sfondin historik të kohës. Ata e nisin veprën me një vështrim gjeografik, historik, ekonomik dhe kulturor për Ulqinin. Janë të dhëna me interes për historinë e këtij qyteti, rrjedhojë e shfrytëzimit të një literature mjaft të pasur. Në rrafshin historik ata vlerësojnë qëndresën e ulqinakëve për mbrojtjen e tokave të tyre. Në një nga aktet e protestave thuhej: *“Pëlqejmë të asgjësohemi sot duke mbrojtur nderin dhe lirinë tonë, prandaj kemi vendosur të mos biem në skllavërinë e Malit të Zi”*. Këtë akt patriotik autorët e zgjerojnë edhe me të dhëna të tjera.

Në rrafshin kulturor ata paraqesin vlerat e këtij qyteti të lashtë shqiptar, shoqëruar edhe me pamje fotografike të monumenteve më me interes të ruajtura disa edhe si relike të një kulture të vjetër.

Në këtë mjedis shqiptar lindi, u rrit dhe zhvilloi një pjesë të veprimtarisë së tij fetare Hafiz Ali Ulqinaku. Ky patriot, veprimtaria e të cilit i përket periudhës së Rilindjes sonë Kombëtare shtegtoi nga Ulqini në Shkodër, me rënien e këtij qyteti në dorë të Malit të Zi e, më pas, shkoi në Lezhë, ku vdiq në vitin 1913, pak kohë pasi ishte shpallur pavarësia e Shqipërisë nga sundimi i gjatë osman, por u varros në Shkodër.

Në monografi analizohet me hollësi veprimtaria e H. Ali Ulqinakut që shtrihet në disa fusha dijeje, si në atë të letërsisë, të gjuhësisë, të arsimit dhe në atë fetare.

Nga fusha e letërsisë, autorët shënojnë përkthimin dhe

përshtatjen e Mevludit në vitin 1873 nga poeti turk nga Bursa e Turqisë Sulejman Çelepi. H. Ali Ulqinaku në shkrimet e tij përdori alfabetin arabo-turk. Në këtë përkthim ndeshemi edhe me elemente përshtatjeje dhe vargje origjinale, që nuk gjenden në librin turqisht. 60 vjet më vonë, më 1933, pas vdekjes së H. Aliut u botua me alfabetin e sotëm *"Mevludi sherif"*, që pati disa ribotime, meqë u mirëprit. F. Luli dhe I. Dizdari për këtë botim me vlera fetare, letrare, edukative dhe gjuhësore, shënojnë faktorët që nxitën H. Aliun të përkthejë këtë vepër. Autori i përkthimit ishte i ndërgjegjshëm për punën që po kryente, pasi donte që me përkthimin në shqip, besimtarët muslimanë të përfitonin më shumë, mbasi në gjuhën turke ajo ishte e pakuptueshme për pjesën më të madhe të popullsisë. Ai mendonte se po hapte një rrugë të re, duke përdorur shqipen dhe një alfabet për shqipen, mbasi, siç thoshte ai, *"ajo asht një gjuhë që me kalem s'asht kallanis"*. Kjo ka ndonjë arsye. Për mendimin tim, të cilin e kam shprehur edhe më parë, ndoshta ka ardhur se ai ka jetuar në një mjedis të mbyllur, pa pasur mundësi për t'u njohur me arritjet e bashkëkombësve të tij në fushën e shkrimit të shqipes ose do të ketë dashur t'i rritë vlerat punës së tij ose të përlligjë gabimet që mund të kishte bërë. Në parathënien e fjalorit të tij të parë shkruante: *"Gjuha shqipe ka mbetur e pashkruar dhe e papërdorur, kështu dukej si e ngrirë dhe e vdekur midis gjuhëve të tjera"*. Në vazhdim të parathënies theksonte se *"nuk i gjente kësaj gjuhe ndonjë të metë, veçse kishte nevojë për ca shkronja dhe shenja"*.

Nga fusha e gjuhësisë, H. Ali Ulqinaku hartoi 3 fjalorë që i quajti *"Ulqin"*. Studiuesi i përmendur, Osman Myderrizi, njohës i gjuhëve orientale, në transkriptimin që i bëri fjalorit *"Shqip-turqisht"* të H. Aliut, e vlerëson më shumë këtë fjalor në krahasim me dy fjalorët e tjerë. Ai numëron te ky fjalor 9021 fjalë, por, duke hequr format e pashtjelluara të foljes dhe fjalët e përsëritura, fjalori përmban rreth 4000 fjalë.

Nga fusha e arsimit, autorët e monografisë theksojnë se H. Ali Ulqinaku ka merita të veçanta në disa drejtime. Ai është udhëhequr nga idealet e Rilindjes sonë Kombëtare; hartoi një abetare, si dhe ushtroi detyrën e mësuesit e atë të drejtorit të shkollës fillore.

Në monografi analizohet më vete abetarja e H. Ali Ulqinakut. Autorët tërheqin vëmendjen se, studiues të ndryshëm, duke mos e njohur fizikisht abetaren, kanë dhënë pak informacion ose fare dhe, në ndonjë punim, një pasqyrë të alfabetit. Kjo abetare, e transkriptuar me alfabetin e sotëm të gjuhës shqipe nga studiuesi kosovar Mehdi Polisi, është përfshirë në monografi. Autorët, si didaktë të njohur, janë marrë me analizën e abetares, duke u ndalur në veçanti në vlerat atdhetare, shkencore, gjuhësore dhe didaktike. H. Ali Ulqinaku, sipas vlerësimit të F. Lulit dhe I. Dizdarit, me këtë vepër arrin një sukses të dukshëm në shkrimin e gjuhës shqipe me shkronjat e alfabetit arab, turko-osman ose persishte. Autorët shprehin kënaqësinë se studiuesit e tjerë do të thellohen më tej në çështjet e mirëfillta gjuhësore të abetares së H. Aliut. Më pas shqyrtojnë vlerat didaktike të abetares dhe merren me përshkrimin e saj. Duke u mbështetur në studiuesit e abetareve të shqipes Sh. Osmani dhe Nj. Kazazi, si dhe F. Luli e I. Dizdari, pranojnë se Hafiz Ali Ulqinaku ka qenë në dijeni të abetareve shqipe dhe të huaja, gjë që del qartë nga krahasimi që mund të bëhet me tekste të tilla. Në vazhdim është paraqitur në një botim anastatik, abetarja me alfabet arab prej 26 faqesh, me një shkrim të M. Polisit për abetaren me titull *"Një vepër e çmuar e Hafiz Ali Ulqinakut"*, shoqëruar me disa të dhëna bio-bibliografike për autorin e shkrimit. Pastaj jepet abetarja e transkriptuar me alfabetin e sotëm të gjuhës shqipe.

Në këtë botim është përfshirë studimi i kryer nga Osman Myderrizi për fjalorin shqip-turqisht të H. Aliut, si dhe transkriptimi i tij me alfabetin e sotëm. Pastaj autorët e monografisë, në 100 faqet në vazhdim, i bëjnë një analizë të hollësishme Mevludit, duke u ndalur në *"Shkrimi dhe botimi i Mevludit"*. Këtu autorët japin vlerësimet e shumë studiuesve për këtë vepër dhe shkrimin e saj. Ata përshkruajnë me hollësi përmbajtjen e Mevludit, duke përfunduar në vlerat e kësaj vepre ku, në mes të tjerash, shënojnë:

1. Vlerat fetare 2. Vlerat edukative 3. Vlerat estetike-artistike 4. Vlerat gjuhësore. Mevludi është shkruar në gjuhën shqipe dhe në të folmen e Ulqinit. Një veprim të tillë autorët e konsiderojnë *"një akt të lartë qytetarie dhe ndërgjegjësimi kombëtar"*. Gjithashtu, jepet një pasqyrë krahasuese e alfabeve

të ndara në këtë mënyrë:

1. Alfabeti i sotëm shqiptar 2. Alfabeti i H. Ali Ulqinakut 3. Alfabeti arab 4. Alfabeti osman Në monografi është botuar edhe *"Fjalorth i arabo-turko-persismav"* që përdorura në *"Huda njaj Zot"*, përkthyer nga Hafiz Ali Ulqinaku, përfshirë në fillim të Mevludit dhe përgatitur nga Tahir Dizdari.

F. Luli dhe I. Dizdari kanë përfshirë edhe vlerësimet që i janë bërë H. Aliut ku theksojnë se tri qytete mburren për të: Ulqini, Shkodra dhe Lezha. Ata kanë regjistruar të gjitha vlerësimet që ka pasur ky autor, duke nisur me botimet, sesionet shkencore, ceremonitë etj. M monografia mbyllet me përfundimet dhe bibliografinë.

Monografia *"Hafiz Ali Ulqinaku, jeta dhe veprat"* të autorëve Faik Luli dhe Islam Dizdari është një vepër e arrirë dhe e suksesshme. Ajo na jep të dhëna me interes, një informacion të pëlqyeshëm dhe të domosdoshëm jo vetëm për studiuesin, por dhe për lexuesin e thjeshtë. Vlerë të veçantë përbën botimi i abetares. Me një vepër të tillë të transkriptuar në alfabetin e sotëm lexuesi njihet për herë të parë.

Autorët kanë shfrytëzuar literaturë të pasur, që nuk pasqyrohet vetëm në 131 libra, por dhe në artikujt e shumtë, shtypin shkencor e periodik, bibliotekat, arkivat etj. Vepra është shkruar me kompetencë, me një gjuhë të thjeshtë dhe të pasur. Ajo, njëkohësisht, është një ndihmesë tepër e vlefshme për krijimet e së kaluarës. Autorët e monografisë meritojnë përgëzime për të gjithë këtë punë të vlefshme e të admirueshme.